

Në bazë të nenit 55 paragrafi 1 të Ligjit për organizim dhe punë të organeve të administratës shtetërore („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 58/00, 44/02, 82/08, 167/10 dhe 51/11) dhe neni 22 dhe 25 të Ligjit për arsim të mesëm („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 44/1995, 24/1996, 34/1996, 35/1997, 82/1999, 29/2002, 40/2003, 42/2003, 67/2004, 55/2005, 113/2005, 35/2006, 30/2007, 49/2007, 81/2008, 92/2008, 33/2010, 116/2010, 156/2010, 18/2011, 42/2011, 51/2011, 6/2012, 100/2012, 24/2013, 41/2014, 116/2014, 135/2014, 10/2015, 98/2015, 145/2015, 30/2016, 127/2016, 67/2017 и 64/18) ministri i Arsimit dhe Shkencës përcaktoi programin mësimor nga lënda e **Informatikës për vitin e dytë** në arsimin e mesëm profesional katërvjeçar.

## 1. Hyrje

Programi i shkurtuar mësimor në lëndën mësimore të Informatikës bazohet në rezultatet e mësimnxënies të parapara me programin mësimor për lëndën mësimore që rregullisht realizohet në pajtim me planin e caktuar mësimor.

Me programin e shkurtuar përcaktohen temat e caktuara dhe njësitë mësimore që duhet realizuar për 159 ditë mësimore, me çka ruhet fondi i paraparë i orëve i caktuar në programin e rregullt, përkatësisht për lëndën mësimore me 2 orë në javë parashihen 64 orë në vitin shkollor 2020/21.

Mësimdhënësi gjatë planifikimit dhe realizimit të njësive mësimore nga programi i shkurtuar udhëhiqet nga rezultatet e mësimnxënies, përmbajtjet, nocionet e caktuara, metodat dhe aktivitetet e përcaktuara në programin e rregullt mësimor.

## 2. Pasqyra e njësive modulare dhe përmbajtjet

| Nr rendor | Njësit modulare              | Përmbajtjet                                                                                                                                                                                                                                   |
|-----------|------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| 1.        | PUNA ME TË DHËNA<br>(18 orë) | Organizim i bazave të dhënave<br>Krijimi i bazave të dhënave të rëndomtë<br>Puna me forma ( ekzemplar)<br>Validizimi i të dhënave<br>Filtrimi progresiv dhe klasifikim i të dhënave<br>Përdorimi i funksioneve për punë me bazën e të dhënave |

|      |                                                 |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                     |
|------|-------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
|      |                                                 | <p>Puna me të dhëna nga tabela të ndryshme</p> <p>Përdorimi i formave online për mbledhjen e të dhënave (Google forms, Wufoo, JotForm etj.)</p> <p>Krijimi I letrës qarkulluese (ang. mail merge) me programin e përpilimit të tekstit me ndërlidhjen e bazës së gatshme të të dhënave me një tabelë</p>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                            |
| 2.1. | MULTIMEDIA DHE GRAFIKA<br>KOMPJUTERIKE (20 orë) | <p>Multimedia, elementet multimediale, dadoteka multimediale, aplikacioni multimedijal, hipermedia, kërkesa harduerike për punë me multimedia</p> <p>Formati I elementeve multimediale, formate tekstuale, formate grafike ,audio dhe video formate</p> <p>Puna me vlerësuesit dhe konvertor</p> <p>Nocioni për grafikën raster dhe të vektorëve dhe formatet e dadotekave grafike</p> <p>Mjedisi I punës ( paleta), ngjyra dhe klasifikime</p> <p>Vizatimi dhe ngjyrosja, puna me brusha dhe goma. Puna me shtresa</p> <p>Përpunimi themelor i fotografisë</p> <p>Animacioni, historijati i animacionit, karakteristikat e animacionit tradicional, karakteristikat e animacionit kompjuterik</p> <p>Llojet e animacionit kompjuterik, mjedisi I punës të programit për përpunimin e 2D animacioneve</p> <p>Puna me shtresa (ang. layers)</p> <p>Krijimi dhe importimi i treguesëve grafik</p> <p>Puna me korniza (ang.frames)</p> |
| 3.   | JETESA ONLINE (12 orë)                          | <p>Nocioni për blog (ueb ditar)</p> <p>Posta elektronike</p> <p>Ueb si burim i informatave</p> <p>Evalumi i informative cilësore dhe burimet cilësore të informatave</p> <p>„Shenjë digjitale“</p> <p>Dhuna digjitale – cyberbullying</p> <p>Marketingu digjital</p>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                |

|    |                               |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                           |
|----|-------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| 4. | UEB – FAQET DHE HTML (14 orë) | Nocioni për ueb faqen – struktura, llojet, SEO, qasja, përshtatja<br>Nocioni për HTML<br>Struktura themelore e HTML dokumentit - html, head, title dhe body<br>Elementet dhe atributet në HTML<br>Puna me tekst<br>Puna me hiperlidhje<br>Puna me tabela<br>Përpunimi i ueb faqes së thjeshtë përmes rregulluesit të HTML |
|----|-------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|

### 3. Rekomandimet didaktike

- Rezultatet nga mësimi në programin mësimor mund të realizohen me paket programor sipas zgjedhjes së mësimdhënësit ose me paket programor që është në disponim të kabineteve të pajisura me kompjuter.
- Udhëzime për lidhje ndërmjet lëndëve (planifikimi I integruar, kryesisht ndërlidhja e qëllimshme dhe përmbajtsore ndërmjet lëndëve dhe fushave të ngjashme):
- gjuha amtare (sintaksa, semantika dhe gramatika);
- matematika (numra të plotë, numra real, system koordinues, trupa gjeometrik, formula, funksione dhe puna me lloje të ndryshme të të dhënave);
- gjuha e huaj (shqiptimi dhe shkruarja e fjalëve dhe nocioneve, mënyra e përpunimit të tekstit );
- arsimit figurativ (kuptimi kreativ dhe vizual të disa detyrave);
- të gjithë lëndët tjera përmbajtjet e të cilave paraqesin përmbajtje në përpunimi e detyrave projektuese.

Për secilën njësi modulare të paraparë është propozuar fond i caktuar i orëve. Nga fondi i përgjithshëm i orëve të parapara në njësit modulare janë lejuar mënjanimet të vogla në pajtim me njohurit e nxënësve, përgatitja paraprake e nxënësve për punën me kompjuter, pajisje plotësuese me të cilën disponon shkolla dhe ngjashëm. Në këtë kontekst disa përmbajtje do të përsëriten disa here në llogari të tjerëve të cilat do të punohen me fond më të vogël të orëve

## VLERËSIMI I TË ARRITURAVE TË NXËNËSËVE

Gjatë mësimit të informatikës rekomandohet përcjellje formative që përfshin përpunimin dhe udhëheqjen e portfolies së nxënësve që përfshin:

- mbledhja e treguesëve ( përpunimet e nxënësëve në kompjuter ) për secilin nxënës në veçanti;
- lista e vlerësive vijuese ( formative) të përgaditura paraprakisht për çdo nxënës në veçanti të cilat përpunohen sipas aktivitetit konkret të tij.

Në fund të çdo tremujorshi , në bazë të njohurive nga vlerësimi formative realizohet vlerësimi mikrosumativ. Sipas natyrës së programit në lëndën e informatikës mësimi mund të realizohet gojrisht, praktikisht, me prezente ngjajshëm. Nxënësi vlerësohet me vlerësim numerik.

### 4. NORMATIVI PËR KUADRIN MËSIMOR

Programin e shkurtuar mësimor e realizon mësimdhënësi në pajtim me normativin për kuadrin mësimor të dhënë në programin e rregullt mësimor.

Programin e shkurtuar mësimor nga lënda mësimore **Informatika për vitin II** në arsimin e mesëm profesional, me propozimin e Byrosë së zhvillimit të arsimit e përcaktoi

**Ministër i Arsimit dhe Shkencës**

---

**Milla Carovska**